**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSA" VLORE**

## VENDIM

Nr. 39, Dt. 06.08.2007

Per miratim ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te burimit ujor, lumi Vjose, per prodhim te energjise elektrike, ne HEC-in "Kaludh" subjektit "Tekno Projekt" sh.p.k. Tirane.

Ne zbatim te Ligjit Nr.8093 Dt.21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr. 9663, dt.18.12.2006 "Per koncesionet", kreu IV, te Vendimit te K.M-ve nr. 27, dt. 19.01.2007, "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve", kreu II, te vendimit te K.K.U-it, nr.3, dt. 19.07.2002 "Per miratimin e rregullores te Sekretariatit Teknik, te K.K.U-it, te K.B.U-es dhe A.U. -it", si dhe udhezimit te M.M.P.A.U dhe M.E.T.E, K.B.U "Vjose":

## VENDOSI:

1. Miratimin ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te burimit ujor, lumi Vjose, ne afersi te fshatit Kaludh, (rreth 2 km ne veri te fshatit Kaludh), per prodhim te energjise elektrike, subjektit "Tekno Projekt" sh.p.k. Tirane.
2. Sasia e ujit qe jepet ne perdorim, per prodhim te energjise elektrike, do te jete (prurja e gjithe lumit) $Q_{mes} = 55\ m^3/sek$.
3. Kuota e marrjes te ujit (aksi i diges), ne afersi te fshatit Kaludh (rreth 2 km poshte tij), me koordinata:
   X = 44 53 260 Y = 44 49 180 Z = 295 m
4. Periudha e shfrytezimit te ujit, gjate gjithe vitit, (nga 1 janari deri me 31 dhjetor).
5. Ngarkohet A.U.B "Vjose" Vlore, per zbatimin e ketij vendimi.
6. Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

**PERGJEGJESI I A.U.B "VJOSE"**
**Vezir METAJ**

**KRYETARE E K.B.U-se**
**Dorothe KONOMI**